

# EPOKA

## ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXIII, nr. 6891  
E mërkurë, 10 maj 2023  
Çmimi 0.40

Draft-statuti i  
Asociacionit,  
Abdixhiku: Shtet  
brenda shtetit | FAQE 5



## AMBASADORI BRITANIK: ËSHTË KOHA QË KOSOVA TA PREZANTOJË DRAFT-STATUTIN PËR ASOCIACIONIN | FAQE 4-5



Ambasadori britanik në Kosovë, Nicholas Abbott, ka thënë të martën se ka ardhur koha që Kosova të propozojë zyrtarisht një draft-statut

për Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe. Sipas tij, një dokument i tillë duhet të paraqitet duke u bazuar në draft-vizionin e

paraqitur nga kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, një javë më parë, si dhe të jetë në përputhje me kriteret e vendosura nga Bashkimi Evropian

KOSOVA SHËNON DITËN E EVROPËS - 9 MAJIN

## KOSOVA E MERITON INTEGRIMIN E PLOTË NË STRUKTURAT EUROATLANTIKE

Përfaqësuesit e pushtetit dhe të opozitës kanë theksuar se Dita e Evropës është mundësi për të reflektuar mbi vlerat që na bashkojnë si popuj evropianë - liria,

demokracia, të drejtat e njeriut dhe sundimi i ligjit. Ata kanë shtuar se vendimi për liberalizimin e vizave për qytetarët e Kosovës dhe pranimi i aplikimit për anëtarësim në

Këshillin e Evropës janë shenja të përafrimit tonë, mbi të gjitha, edhe përbushje e premtiveve të kamotshme që Bashkimi Evropian i kishte dhënë Kosovës



Na ndiqni edhe në:  
[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)  
 [facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"](https://facebook.com/Gazeta%22Epoka%20e%20re%22)



AKTUALE



A MUND TA SHMANGË  
BIDENI FALIMENTIMIN PËRMES  
AMENDAMENTIT 14? [F. 2](#)

SCHOLZ: NORMALIZIMI I  
RAPORTEVE NË MES TË  
KOSOVËS DHE SERBISË DUHET  
TË VAZHDOJË [F. 3](#)

PËRZGJIDHEN SHEFAT NË  
GJINEKOLOGJI, ISH-DREJTORI I  
SHSKUK-SË, CURR GJOCAJ,  
UDHËHEQ REPARTIN E PRANIMIT [F. 6](#)

EKONOMI



ZRRE-ja TREGON TRI ARSYE  
PËR GJOBITJEN E KEK-ut  
DHE KOSTT-it [F. 8](#)

SPORT



NORA GJAKOVA PËRFUNDON E PESTA  
NË KAMPIONATIN BOTËROR,  
SOT GARON LAURA FAZLIU [F. 10](#)

# A mund ta shmangë Bideni falimentimin përmes Amendamentit 14?

REUTERS

Presidenti amerikan Joe Biden i ka thirrur në takim më 9 maj udhëheqësit e Kongresit amerikan për të biseduar përriten e tavanit të borxhit. Kongresi amerikan është i ndarë dhe nuk ka ngelur shumë kohë për ta rritur tavanin e borxhit të Qeverisë federale në vlerë prej 31.4 trillionë dollarësh, me Departamentin e Thesarit që ka paralajmëruar se mund të mbesë pa para deri më 1 qershor.

Nëse Kongresi dështron të veprojë, disa ekspertë thonë se presidenti Biden mund të ketë edhe një opsjon për ta shmangur krizën: ta përdorë Amendamentin 14 të Kushtetutës amerikane që të sigurohet se ShBA-ja të vazhdojë t'i paguajë faturat.

Çfarë thotë Amendamenti i 14-të?

Neni katër i Amendamentit 14, i miratuar pas Luftës Civile të viteve 1861-1865, thotë se "vlefshmëria e borxhit publik të Shteteve të Bashkuara... nuk duhet të vihet në dyshim".

Historianët thonë se ky amendament synon të sigurojë që Qeveria federale të mos mohojë borxhet e saj sikurse që kishin bërë disa ish-konfederata. Por, kjo klauzolë gjérësiqë nuk është adresuar nga gjykatat dhe ekspertët ligjorë nuk pajtohen se çfarë ajo kërkon nga Kongresi dhe Presidencia.

Disa, sikurse profesori i juridikut në Universitetin Cornell, Michael Dorf, thonë se opzioni "më pak antikushtetues" do të ishte që Bideni të vepronë vetë për ta mbrojtur integritetin e borxhit kombëtar.



"Kjo nënkupton huazimin e parave", tha ai.

Çdo veprim që mund të ndërmarrë Bideni ka të ngjarë ta nxisë inicimin e procedurave ligjore.

## Kush mund të ngrehë padi për tavanin e borxhit?

Nuk është e quartë se kush do të mund të ngrehë një çështje të tillë ligjore. Mund të jetë e vështirë për çdo paditës që të dëshmojë se janë dëmtuar nga ndonjë veprim.

Një vendim i Gjykatës Supreme amerikane i vitit 1997 tha se ligjvënës të vetëm nuk mund të iniciojnë padi të tilla, por Kongresi potencialisht mund të votojë për të thënë se është

dëmtuar në mënyrë kolektive. Gjykata Supreme, po ashtu, mund të zgjidhë që të dëgjojë ndonjë sfidë ligjore me qëllim që ta zgjidhë shpejt çështjen, ashtu siç ka bërë me vendimin e Bidenit për të anuluar 430 miliardë dollarë borxhe të studenteve.

Por, një rast i tillë do të bëhej në një territor të pashkelur ligjor.

Gjykata Supreme ka vendosur vetëm një herë për klauzolën e borxhit publik, kur më 1935 ishte sfiduar vendimin e presidentit demokrat, Franklin Roosevelt, për të hequr ShBA-në nga standardi i arit [një sistem ku shtetet rregullonin vlerën e monedhave të tyre kombëtare në bazë të një sasie specifikë të arit]. Gjykata kishte vendosur se pala paditëse, një pronar i letrave me vlerë, nuk kishte bazë

për të ngritisur një çështje të tillë ligjore.

Biden dhe Kongresi, ndërkokë, do të jenë nën presion të madh për ta zgjidhur këtë çështje sa më shpejt që të mundet, që nënkupton se çdo rast ligjor mund të bëhet i parëndësishëm ende para arritur para ndonjë gjykate.

## Cili është qëndrimi i Shtëpisë së Bardhë për Amendamentin 14?

Herët e fundit kur kjo çështje u aktualizua në Uashington ishte më 2011 dhe 2013, kur zyrtarë të lartë demokratikë, përfshirë ish-presidentin Bill Clinton, i bënë thirrje presidentit të atëhershëm, Barack Obama, që të përdorte Amendamentin 14.

Por, këshilltarët e Shtëpisë së Bardhë kishin argumentuar se nuk besonin se kishin autoritetin ligjor për të bërë një gjë të tillë.

Sekretarja amerikane e Thesarit, Janet Yellen, kishe dekluaruar më 2021 se përdorimi i Amendamentit 14 nuk ishte opsjon, dhe se disa nga këshilltarët e ish-presidentit Obama, sikurse Gene Sperling, tani punojnë në Shtëpinë e Bardhë në administratën e Bidenit.

Zëdhënësit e Shtëpisë së Bardhë nuk u janë përgjigjur kërkeseve për koment lidhur me këtë çështje.

**Si do të reagonin tregjet nëse Bideni do ta përdorte Amendamentin 14?**

Zyrtarët e administratës dhe ekonomistët kanë paralajmëruar se një falimentim, i nxitur nga tejkalimi i tavanit të borxhit, do ta trondiste sistemin financiar dhe do ta fuste ShBA-në në recession.

Ky rezultat katastrofal mund të shmanget nëse Bideni do ta përdorte Amendamentin 14. Megjithatë, investitorët do të mund të trembeshin nga e gjithë ajo dramë dhe të kërkonin norma më të larta të interesit, që do të reflektonin në rritjen e rrezikut derisa paqartësitë ligjore të zgjidheshin. "Ky është një rrezik mjaft i madh që do të ndërmerrte presidenti", tha Mark Zandi, shefi i ekonomistëve në Moody Analytics. "Por, ndoshta ky është opzioni më i mirë për të nëse futeni në atë skenar". / Rel

## OKB: Kriza ushqimore do ta destabilizojë edhe më shumë Lindjen e Mesme

**ROMË, 9 MAJ** - Programi Botëror i Ushqimit ka shprehur shqetësimë se një krizë e vazhdueshme ushqimore në Lindjen e Mesme mund ta destabilizojë edhe më shumë rajonin.

Pesë shtete në këtë rajon janë duke u përballur me norma të inflacionit mbi 60 për qind, ndërsa disa të tjera me nivele tresiflore, ka thënë Corinne Fleischer, drejtoreshë e Programit Botëror të Ushqimit

për rajonin e Lindjes së Mesme. "Kur ushqimi bëhet i papërbollueshëm, rezultat është uria", ka thënë ajo përmes një deklarate.

Varësia ndaj importeve dhe kriza klimatike është thënë se vetëm mund ta përkëqësojnë situatën. Programi Botëror i Ushqimit - Agjencia e Komeve të Bashkuara - ka thënë se ushqimi në këtë rajon blihet me çmime të larta, pasi vetë rajoni nuk prodhon mjaftueshëm ushqim.

Ndërkokë, thatësia, valët e të nxehtit, zjarret pyjore dhe vërvshimet, janë duke shkatërruar një pjesë të mirë të tokës pjellore.

Libani është shteti që është duke u përballur më së shumti me këto probleme. Sipas Bankës Botërore, ky shtet renditet si një prej vendeve me inflacionin më të lartë në botë. Siria është përmendur, po ashtu, si vend që vuan nga kushtet e rënda.



# Ambasadori britanik: Është koha që Kosova ta prezantojë draft-statutin për Asociacionin

Ambasadori britanik në Kosovë, Nicholas Abbott, ka thënë të martën se ka ardhur koha që Kosova të propozojë zyrtarisht një draft-statut për Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe. Sipas tij, një dokument i tillë duhet të paraqitet duke u bazuar në draft-vizionin e paraqitur nga kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, një javë më parë, si dhe të jetë në përputhje me kriteret e vendosura nga Bashkimi Evropian

EPOKA  
ERE

Mal QORRAJ

**PRISEHTINË, 9 MAJ** - Ambasadori i Mbretërisë së Bashkuar, Nicholas Abbott, ka deklaruar se është koha që Kosova të propozojë zyrtarisht një draft-statut për Asociacionin, duke u bazuar në draft-vizionin e paraqitur nga kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, një javë më parë, si dhe të jetë në përputhje me kriteret e vendosura nga Bashkimi Evropian.

Abbott në "Facebook" ka shkruar se draft-statutit i ri duhet të jetë në përputhje me kriteret e përcaktuara nga Bashkimi Evropian. "Është koha që Kosova të propozojë zyrtarisht një draft-statut për një Asociacion, duke u mbështetur në vizionin e vendosur nga kryeministri javën e kaluar, në përputhje me kriteret e përcaktuara nga BE-ja", ka shkruar Abbott.

Ambasadori ka njoftuar se gjatë kësaj javë në Kosovë do të ketë vizita të rendësishme. "Këtë javë do të ketë vizitorë të rendësishëm në Prishtinë, duke përfshirë drejtoreshën e Britanisë për Ballkanin Perëndimor", ka thënë ambasadori, duke shtuar se aleatët e Kosovës duan të shohin përparim në normalizimin e marrëdhënive me Serbinë. "Aleatët e Kosovës duan të shohin përparim në normalizimin e marrëdhënive me Serbinë", ka thënë ai.

Më 2 maj, në kuadër të dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë, në



Bruksel është prezantuar draft-statuti për Asociacionin, i përpiluar nga një ekspert menaxhues, i përbërë prej katër pjesëtarëve të komunitetit serb. Ky ekspert është shkarkuar një ditë më vonë nga autoritetet e Kosovës.

Kryeministri Kurti ka thënë se draft-statutit i prezantuar është "fundamentalist i papajtueshëm me kushtetutshmërinë" e vendit. Si përgjigje, ai e ka prezantuar më

pas një draft-vizion që, sipas tij, rregullon çështjen e komuniteteve joshumicë në Kosovë.

Në këtë dokument të Kurtit thuhet, mes të tjera, se ai do t'u ofrojë mundësi pjesëtarëve të komunitetit serb në Kosovë për të promovuar dhe mbrojtur të drejtat e tyre përmes "kormizës së vetëmenaxhimit", kanal të drejtpërdrejtë komunikimi me Qeverinë e Kosovës, si dhe

mundësi për t'u financuar nga Kosova dhe vende të tjera, përfshirë edhe Serbinë.

Kosova dhe Serbia kanë arritur marrëveshje për Asociacionin më 2013 dhe më pas më 2015 mbi parimet për themelimin e tij.

Po më 2015, Gjykata Kushtetuese e Kosovës ka gjetur se marrëveshja nuk është në harmoni të plotë me Kushtetutën. Serbia kërkon që Kosova t'i zbatojë marrëveshjet e arritura,

por Qeveria aktuale e Kosovës është deklaruar kundër një asociacioni njëetnik.

Me ndërmjetësimin e BE-së dhe mbështetjen e Shteteve të Bashkuara, dy vendet janë në negociata për normalizimin e marrëdhënive qysh nga viti 2011. Ato kanë arritur dhjetëra marrëveshje, por shumica e tyre nuk janë zbatuar dhe palët kanë fajësuar njëra-tjetër përgjigje.

## Scholz: Normalizimi i raporteve në mes të Kosovës dhe Serbisë duhet të vazhdojë



**PRISEHTINË, 9 MAJ** - Kancelari gjerman Olaf Scholz i bëri thirrje Bashkimit Evropian që t'i mbajë premtimet ndaj vendeve të Ballkanit Perëndimor për integrimin e tyre në BE.

Në një fjalim para Parlamentit Evropian për të ardhmen e Evropës, Scholz bëri thirrje edhe përvazhdimin e normalizimit të marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe Serbisë. "Evropa duhet të hapet edhe ndaj të tjerëve. Vendime kyçe për Evropën ishin ato të vitit të kaluar, kur vendosëm të punojmë për një Evropë të zgjeruar. U kemi thënë vendeve të Ballkanit Perëndimor, po ashtu edhe Ukrainës, Moldavisë, ndoshta, edhe Gjeorgjisë, se e kanë vendin në Evropë", tha Scholz, duke shtuar se Evropa gjopolitike duhet t'i mbajë premtimet e veta.

"Premtimet duhet të mbahen ndaj vendeve të Ballkanit, të cilave po u premtojmë anëtarësim tash e 20 vjet. Normalizimi i raporteve në mes të Kosovës dhe Serbisë duhet t'

vazhdojë. Duhet t'ë vazhdojnë reformat për integrim. Duhet t'ë avancohet edhe procesi i negociatave me Maqedoninë e Veriut. Zgjerimi nuk duhet të jetë i vërtmi motiv për reforma, por

duhet t'ë kihet parasysh", tha kancelari gjerman.

Nga vendet e Ballkanit Perëndimor, Mali i Zi dhe Serbia kanë bërë më së shumti përvazhdimin në negociatat e anëtarësimit në BE, ndërsa Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut i kanë hapur vitin e kaluar këto negociata. Bosnjë-Hercegovina ka marrë statusin e vendit kandidat, ndërsa Kosova ka aplikuar përanëtarësim në BE dhjetorin e kaluar.

Perspektiva evropiane e vendeve të Ballkanit Perëndimor është premtuar qysh në vitin 2003, kur përfaqësuesit e Shteteve anëtarë të BE-së, të mbledhur në një samit në Selanik të Greqisë, kanë miratuar një deklaratë të përbashkët përkëtë qëllim. Duke folur në Ditën e Evropës, që shënitet më 9 maj, Scholz tha se

"sa më e bashkuar që është Evropa, aq më lehtë do të përballet me sfidë". "Ne duhet t'ë jemi edhe më të hapur ndaj të tjerëve. Na duhet një BE e zgjeruar dhe e reformuar, një BE gjeostrategjike. Rrallëherë kemi qenë më të bashkuar sesa tash në përballe me agresionin e Rusisë [në Ukrainë]", tha Scholz.

Kancelari gjerman tha, po ashtu, se Bashkimi Evropian po punon përmirësuar regjimin e sanksioneve kundër Rusisë për shkak të pushtimit të Ukrainës. Duke iu përgjigjur një pyetjeje nëse ai është në favor të zgjerimit të propozuar të sanksioneve me përfshirjen edhe të kompanive kineze, Scholz tha se qëllimi është përmirësimi i sanksioneve ekzistuese dhe se paketa e ardhshme e sanksioneve nuk do të jetë e fundit.



KOSOVA SHËNON DITËN E EVROPËS - 9 MAJIN

# Kosova e meriton integrimin e plotë në strukturat euroatlantike

Përfaqësuesit e pushtetit dhe të opozitës kanë theksuar se Dita e Evropës është mundësi për të reflektuar mbi vlerat që na bashkojnë si popuj evropianë - liria, demokracia, të drejtat e njeriut dhe sundimi i ligjit. Ata kanë shtuar se vendimi për liberalizimin e vizave për qytetarët e Kosovës dhe pranimi i aplikimit për anëtarësim në Këshillin e Evropës janë shenja të përafrimit tonë, mbi të gjitha, edhe përbushje e premtimave të kamotshme që Bashkimi Evropian i kishte dhënë Kosovës

EPOKA  
ERE

Mal QORRAJ

**PRISHTINË, 9 MAJ** - Presidentja Vjosa Osmani, me rastin e Ditës së Evropës, ka theksuar se Kosova është mishërim i vlerave evropiane. "Dita e Evropës është mundësi për të reflektuar mbi vlerat që na bashkojnë si popuj evropianë - liria, demokracia, të drejtat e njeriut dhe sundimi i ligjit. Këto parime themelore kanë qenë shtylla të rëndësishme të Bashkimit Evropian që nga formësimi i tij e janë pikërisht këto vlera për të cilat Kosova dhe populli i saj kanë luftuar historikisht dhe vazhdojnë t'i mbrojnë edhe sot", ka dekluaruar Osmani.

Ajo ka theksuar se në këtë kohë përcaktuese, Dita e Evropës shërben si një kujtesë e fuqishme për rëndësinë e solidaritetit, unititetit dhe mbrojtjes së njëritjetrit. "Le ta shfrytëzojmë këtë moment për të reflektuar mbi të gjitha sukseset që kemi arritur deri tanë dhe për ta rikonfirmuar vullnetin tonë të pashembullt për sukseset të reja në rrugën drejt

integrimit evropian. Kosova dhe populli i saj kanë qenë, janë dhe do të mbeten gjithnjë mishërim i këtyre vlerave. E gjersa afrohemë më shumë drejt Bashkimit Evropian, angazhimi ynë mbetet i palëkundur, sepse vendosmëria jonë për demokraci, paqe, të drejta të njeriut e sundim të ligjit, mbetet i palëkundur", është shprehur Osmani.

Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, ka thënë se Dita e Evropës, sidomos në kohën kur po ndodh lufta në Ukrainë, thërret një Evropë që në bazë ka ekonominë, por të asaj natyre që i rri përshtat thellësisë politike dhe linjave të qarta gjeopolitike, pa flitime me elemente autoritare, që do ta rrezonte parimin e demokracisë. "Kosova është sot një shembull i shkëlqyer i demokracisë dhe vlerave universale të Bashkimit Evropian, me të cilat shteti ynë synon të jetë sa më i akorduar, përtëj të cilave nuk mund të bëhet lëshim, sepse ekzistencë e tij është e lidhur thelbësishët me të qenit e tij demokraci dhe vend i këtyre vlerave universale. Rruga e

Kosovës është vetëm një, është ajo e Evropës, e frysës dhe parimeve të saj dhe çdo propozim tjetër është cenim i saj dhe i këtyre parimeve", ka thënë Konjufca.

Ai ka shtuar se rruga e vendeve joanëtare për në BE është njëkohësisht edhe rruga e BE-së drejt idesë së lartë të Evropës së Bashkuar, rruga ku ajo duhet ta përbushë vvetvenet duke takuar vlerat e saj.

"Sot festojmë Ditën e Evropës, për një Bashkim Evropian sa më të thelli, që nuk reduktohet në peshë teksha vijon procesin e zgjerimit. Gëzuar 9 Majin, Ditën e Evropës, ditën e aspiratës së lartë të paqes së drejtë, demokracisë dhe vlerave universale!", ka dekluaruar Konjufca.

Kryeministri Albin Kurti me fjalët e Robert Schuman, ministrit për Evropë dhe Çështje të Jashtme të Francës, në deklaratën e tij të bërë më 9 maj 1950, i ka uruar qytetarët e Kosovës për Ditën e Evropës. "Evropa e bashkuar nuk u arrit dhe kishim luftë. Evropa nuk do të bëhet menjëherë, ose sipas një plani të vetëm. Ajo do të

ndërtohet përmes arritjeve konkrete të cilat së pari krijojnë një solidaritet de facto", kishte thënë Schuman.

Kurti ka thënë se i themeluar mbi vlera e vizion, Bashkimi Evropian është projekti më i madh politik dhe procesi më i rëndësishëm historik i paqes dhe prosperitetit që nga Lufta e Dytë Botërore. "Është ideja e bashkëpunimit përmes institucioneve të përbashkëta që krijoj tregun unik dhe e bëri BE-në ekonominë më të madhe të botës. Në dhjetorin e vitit që e lamë pas dorëzuam aplikimin për anëtarësim në Bashkimin Evropian. Muajin e kaluar u nënshkrua vendimi për liberalizimin e vizave, ndërkëq në fund të prillit kaluan me sukses fazën e parë të anëtarësimit në Këshillin e Evropës", ka thënë Kurti.

**Në Ditën e Evropës edhe liderët opozitarë japid mesazhe**

Kryetari i PDK-së, Memli Krasniqi, ka thënë se shqiptarët e Kosovës kanë dëshmuar për dekada se janë vlerë e shtuar dhe aset tejet i rëndësishëm - me kontributin e tyre të shquar në të gjitha shtetet e Evropës ku jetojnë dhe punojnë. "Mërgata janë janë qytetarë të dalluar dhe të suksesshëm gjithandje BE-së. Fatmirësish, pas shumë përpjekjeve, ndonjëherë edhe vonesave të panevojshme, edhe shteti ynë, Kosova, tashmë ka hyrë në rrugën e pakshim -

drejt përqafimit të vlerave evropiane dhe integrimit e anëtarësimit në këtë Bashkësi", ka thënë Krasniqi.

Ai ka theksuar se vendimi për liberalizimin e vizave për qytetarët e Kosovës dhe pranimi i aplikimit për anëtarësim në Këshillin e Evropës janë shenja të përafrimit tonë, mbi të gjitha, edhe përbushje e premtimave të kamotshme që Bashkimi Evropian i kishte dhënë Kosovës. "Prandaj, para së gjithash, ky vit, i cili shënon një pikë kthuese për Kosovën dhe BE-në, uroj të konkretizohet sa më parë me marrjen e statusit kandidat dhe më pas anëtarësimit të plotë të Kosovës në BE", është shprehur Krasniqi.

Lideri i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka thënë se nuk ka vend neë Evropë më te përkushtuar ndaj idealeve të BE-së sesa Kosova e cila është pjesë e natyrshme e familjes europerëndimore. "Vendimi për liberalizimin e vizave për Kosovën dhe pranimi i aplikimit për anëtarësim në Këshillin e Evropës janë dëshmi për vlerat evropiane që ne i përfaqësojmë me Kushtetutën dhe ligjet tona. Kosova e meriton integrimin e plotë në strukturat euroatlantike!

Ky është një synim për të cilin jemi përcaktuar si shtet, të orientuar për të kontribuar në prosperitetin, paqen, sigurinë, dhe drejtësinë e kontinentit tonë, përkrah shteteve të tjera të Evropës", ka thënë Haradinaj.

## Draft-statuti i Asociacionit, Abdixhiku: Shtet brenda shtetit

**PRISHTINË, 9 MAJ** - Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Lumir Abdixhiku, ka thënë se dokumenti i draft-statutit, i përpiluar nga ekipi menaxhues, e i bërë publik në medie, është më tepër se Asociacion dhe është më tepër se Autonomi - është shtet brenda shtetit; Republikë brenda Republikës. "Ky draft-statut, në të 67 nenet e në nëntë kapitujt e tij, projekton federalizimin e Kosovës si koncept të ri organizativ pas shpalljes së pavarësisë. Një trup që nxjerrë ligje, menaxhon asete kombëtare, pasuri publike e burime natyrore, një trup që organizon zgjedhje, mban referendume e merr kompetenca nga Kuvendi dhe Qeveria e Kosovës - nuk ka

vend në rregullimin tonë shtetëror e kushtetues", ka thënë Abdixhiku, duke shtuar se, si i tillë, ai jo vetëm që duhet të refuzohet si bazë negociuese, por edhe të refuzohet si ambicie politike. Abixhiku ka thënë se në Kosovë nuk do të ketë parti, nuk do të ketë qeveri e nuk do të ketë njeri që mund ta pranojë një organizim të tillë. "Qeveria e Kosovës duhet të marrë pronësinë në procesin vijues. Asociacioni bëhet nga institucionet tona dhe vetëm brenda rendit tonë kushtetues. Çdo ikje nga përgjegjësia është dorëzim dhe çdo dorëzim sjell dokumente dhe koncepte të tillë, siç ka ndodhur edhe me këtë tanë", ka thënë lideri i LDK-së, Lumir Abdixhiku.



## Zëvendësshefja e stafit e presidentes dhe këshilltarja politike takojnë zyrtarë amerikanë në ShBA



**PRISHTINË, 9 MAJ** - Zëvendësshefja e stafit e presidentes, Learta Hollaj dhe këshilltarja politike, Donika Kadaj-Bujupi, u takuan sot me këshilltarin e

lartë në Zyrën për Çështje të Evropës Jugore dhe Qendrore në Departamentin e Shtetit Amerikan, Paul Pfeuffer, dhe Zyrtaren e Departamentit të Shtetit Amerikan në Deskun

për Kosovën, Anne Morrison. Presidencia ka njoftuar se në takim u diskutua për zhvillimet e fundit në Kosovë, me fokus të veçantë në sukseset e Kosovës në

kuadër të Samitit për Demokraci, si dhe për arritjet e Kosovës në fushën e sundimit të ligjit dhe avancimin e vazdueshëm të demokracisë.

Palët diskutuan edhe për zhvillimet më të fundit në procesin e dialogut si dhe për mundësitë e shumta për avancim të mëtejmë të raporteve bilaterale.

# Përzgjidhen shefat në Gjinekologji, ish-drejtori i ShSKUK-së, Curr Gjocaj, udhëheq Repartin e Pranimit

**PRISHTINË, 9 MAJ** - Në Klinikën e Gjinekologjisë në QKUK janë përzgjedhur shefat për 10 reparte, një prej tyre është edhe Curr Gjocaj, ish-drejtor i ShSKUK-së.

Ish-drejtori i ShSKUK-së është një nga shefat e përzgjedhur në konkursin e Klinikës së Gjinekologjisë në QKUK.

Gjocaj kishte kandiduar në tre reparte, ndërsa është përzgjedhur shef i Repartit të Pranimit dhe Ambulancave Specialistike nga komisioni i cili është udhëhequr nga drejtori i klinikës, Zef Ndrezaj. Në repartin e Patologjisë së Barrës shef është përzgjedhur

gjinekologu Naser Rafuna, ndërsa Reparti i Infertilitetit me FAM do të udhëhiqet nga Leandrit Bejtullahu, shkruan gazeta "Shneta".

Shpresa Musolli-Krasniqi është shefja e re e Sallave të Lindjes, ndërsa reparti i Lehonave me Sekcio do të drejtohet nga Sahadete Shala.

Gjinekologu Afrim Veliu do ta udhëheqë sërisht Repartin Paranatal, ndërsa Sabedin Fejzullahu është përzgjedhur në Onkologji.

Reparti i Lehonave do ta ketë shefe Igball Gerbeshi-Musliu, ndërsa në Konservativë është përzgjedhur Vlora Ademi-

Ibishi. Reparti i operativës ku kryhen operacionet e rënda do të udhëhiqet nga gjinekologia Nexhmije Spahija.

Në këtë klinikë, po ashtu, janë publikuar edhe rezultatet e konkursit për kryeinfermieri. Sabrije Obertinca është përzgjedhur sërisht në pozitën e kryeinfermierës së klinikës, ndërsa Sevime Kamberi-Bajqinovci kryeinfermieri në repartin e Patologjisë.

Melihate Rexhepi është kryeinfermieri në Konservativë, ndërsa Gjejlane Gjaka në ambulanca specialistike.



## Kurti bëri homazhe te varret e Ilir Konushevcit dhe Hazir Malajt



**PRISHTINË, 9 MAJ** - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, bëri të martën homazhe dhe vendosi kurora me lule te varret e heroit të kombit Ilir Konushevci dhe doktor Hazir Malajt, në 25-vjetorin e rënies së tyre.

Gjatë homazheve kryeministri Kurti tha se sot jemi bërë me kolegë ministra e deputetë, me zëvendeskryeministren Rexhepi dhe me familjet Konushevci dhe Malaj, që të bëjmë nderime para këtyre dy dëshmorëve të kombit të cilët nuk kursyen asgjë e të cilët dhanë jetën në mënyrë që populli shqiptar të jetojë i lirë në tokën e vet. "Pjesën kryesore dhe më të madhe të ecjes politike, shoqërore në

vendin tonë e kanë kryer dëshmorët e kombit, ndërkaq neve na ka mbetur një pjesë më e vogël, por e rendësishme e punës, e cila bëhet mirë e mbarë pikërisht duke i pasur si udhërrëfyes dëshmorët dhe martirët të cilët janë edhe dëshmi e krimeve të Serbisë në Kosovë, njëkohësisht dhe vullnetit të paepur të popullit tonë përliri", ka thënë Kurti. Në këto homazhe kryeministri Kurti u shoqërua nga zëvendëskryeministrja Emilja Rexhepi, ministria e Drejtësisë Albulena Haxhiu, deputetët e Kuvendit të Kosovës, Enver Dugolli dhe Driton Hyseni dhe asamblistë dhe aktivistë të Lëvizjes Vetëvendosje, Qendra e Prishtinës.

## Nura thotë se qeveria nuk ka ndarë asnje cent për Skenderajn pas vërvshimeve

**SKENDERAJ, 9 MAJ** - Qeveria e Kosovës ende nuk i ka kompensuar dëmet për komunat e prekura nga vërvshimet e këtij viti ani pse është zotua se do të bëjë një gjë tillë.

Kryetari i komunës së Skenderajt, Fadil Nura, thotë se asnje hap nuk është marrë nga Qeveria e Kosovës madje, sipas tij, nuk janë ftuar as në takime për ta trajtuar këtë çështje. Nura thotë se ka pasur

takim me Komisionin Qendor, por informacione nga qeveria se çfarë do të bëjë me premtimin e dhënë nuk ka. "Asnjë hap nuk është marrë, as nuk ka informata që do të merret ndonjë hap tash e tutje. Ne e kemi kryer punën tonë, i kemi vlerësuar të dhënat ashu siç thotë Ligji mbi Fatkeqësitetë Natyrore. Ne kemi proceduar më tutje, me Komisionin Qendor kam pasur takim. E trajtoi këtë

çështje dhe e ka përcjellë në qeveri, por më tepër nuk kam asnjë informatë", ka thënë Nura përgazetën "Blic".

Nura ka treguar se në Skenderaj kanë filluar pesë shtëpi që janë shkatërruar nga vërvshimet. Për ndërtimin e tyre ai i ka falënderuar Halil Kastratin dhe Selim Pacollin. Në komunën e Skenderajt dëmet nga vërvshimet llogariten mbi 10 milionë euro.



## Taulant Kelmendi emërohet zëvendësministër i Arsimit

**PRISHTINË, 9 MAJ** - Kryeministri Albin Kurti ka emëruar Taulant Kelmendin në pozitën e

zëvendësministrit të Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit. Sipas njoftimit nga Zyra e Kryeministrat,

Kurti e ka uruar Kelmendin për detyrën e re dhe përmbrashjen e përgjegjësive të reja.

Kelmendi është anëtar i Këshillit të Përgjithshëm në Lëvizjen Vetëvendosje nga Peja.



# ZRRE-ja tregon tri arsyen për gjobitjen e KEK-ut dhe KOSTT-it

Prishtinë, 9 maj - Zyra e Rregulatorit të Energjisë (ZRRE) konstaton se Korporata Energetike e Kosovës (KEK) ka blerë energji elektrike nga kompania slovene "Holding Slovenske Elektrarne" e cila nuk ka licencë të lëshuar nga autoritetet e Kosovës.

ZRRE-ja ka bërë me dije se në përputhje me të gjeturat në raportet e monitorimit, ka shqiptuar gjobë për KEK-un 3.2 milionë euro dhe për Operatorin e Sistemit të Transmetimit dhe Tregut (KOSTT) 439 mijë euro.

Përveç tregtimit të energjisë me kompani të palicencuara, KEK-u ka kërkuar energji elektrike nga Shqipëria edhe kur nuk ka pasur nevojë si dhe ka bërë shitje të energjisë elektrike në kundërshtim me Ligjin e KOSTT-it për mbulimin e humbjeve në katër komunat veriore.

Megjithatë, ministria e Ekonomisë, Artane Rizvanollit, ka thënë se ende nuk kanë informata zyrtare për ndëshkimin e dy kompanive publike të cilat monitorohen nga dikasteri që e udhëheq ajo.

Nëpërmjet këtij raporti, ZRRE-ja ka konstatuar se, pavarësisht prej vërejtjeve të dhëna nga rregulatori, KEK-u ka vazhduar të blejë energji elektrike nga kompania slovene "Holding Slovenske Elektrarne" e cila nuk kishte licencë të lëshuar nga autoritetet e Kosovës.

Ky tregtim konsiderohet se është një ndër arsyet pse ZRRE-ja ka gjobitur KEK-un 3.2 milionë euro. "Në përputhje me të gjeturat në raportet e monitorimit, Bordi i ZRRE-së ka shqiptuar gjoba për ndërmarrjet", thuhet në një



përgjigje me shkrim nga ZRRE-ja, duke shthuar se në bazë të raporteve të monitorimit kanë gjobitur edhe ndërmarrje të tjera publike për KOSTT-in, Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes (KEDS) dhe Furnizuesin me Shërbim Universal (KESCO) dhe Hidrocentralin e Ujmanit. Sipas raportit të monitorimit të ZRRE-së ndaj KEK-ut për vitin 2022, në dhjetor të vitit 2018 KEK-u kishte hapur tender për "parakualifikim për aktivitetin e prokurimit - shitje së energjisë elektrike" me ç'rast kishte nënshkruar kontrata kornizë me disa kompani ndërkombëtare. KEK-u me tetë kompanitë që

kishte nënshkruar kontrata, njëra prej tyre nuk kishte licencë, kompania "Holding Slovenske Elektrarne" nga Sllovenia. Lidhur me këtë, ZRRE-ja theksón në raport se ka reaguar disa herë përmes emailit zyrtar si dhe me shkresë zyrtare, ku ka kërkuar nga KEK-u të veprojë në pajtim me obligimet ligjore dhe ta ndalojë aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike me kompani të palicencuara bie në kundërshtim me Ligjin për Energji Elektrike si dhe Ligjin për Rregulatorin e Energjisë.

elektrike me ndërmarrje të palicencuara, KEK-u ende kryen aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike në mospajtueshmëri me obligimet ligjore", thuhet në raport. Po ashtu, ZRRE-ja ka konstatuar se tregimi i energjisë elektrike me kompani të palicencuara bie në kundërshtim me Ligjin për Energji Elektrike si dhe Ligjin për Rregulatorin e Energjisë.

## KEK-u ka kërkuar energji nga Shqipëria edhe kur nuk ka pasur nevojë

Në raportin e monitorimit për KEK-un thuhet se kjo kompani

ka kërkuar energji elektrike nga Korporata Energetike e Shqipërisë (KESH) edhe atëherë kur nuk pasur nevojë. "KEK-u ka kërkuar energji nga KESH-i edhe atëherë kur nuk ka pasur nevojë për FShU dhe energjinë e pranuar nga KESH e ka ofruar në treg të lirë. Një veprim i tillë bie në kundërshtim me nenin 1 të marrëveshjes për shkëmbim/depozitum të energjisë elektrike në mes të Korporatës Elektroenergetike Shqiptare (KESH) dhe Korporatës Energetike të Kosovës (KEK)", theksón ZRRE-ja.

## Shitia e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve të veriut

Në bazë të këtij raporti, shkelje tjetër po konsiderohet edhe shitja e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në katër komunat veriore. "KEK-u i shet energji elektrike KOSTT-it për mbulimin e humbjeve në veri të vendit, nën kushtet e marrëveshjes për mbulimin e humbjeve të sistemit. Shitia e energjisë elektrike te KOSTT-i për mbulimin e humbjeve në veri bie në kundërshtim me procedurën e tregtimit të energjisë elektrike, pasi që në procedurë përcaktohet që tregimi i energjisë elektrike duhet t'i nënshتروhet tregut të lirë dhe konkurrues", vazhdon raporti.

Ndërkohë, Bordi i ZRRE-së në seancën e së premtes, pas shqyrimit përfundimtar të raporteve të monitorimit, ka vendosur gjobë në vlerë prej 3.2 milionë eurosh për KEK-un dhe 439 mijë euro për KOSTT-in.

# Bajrami paralajmëron dërgimin në Kushtetuese të Projektligjit për Fondin Sovran



**PRISHTINË, 9 MAJ** - Deputetja e LDK-së, Hykmete Bajrami, thotë se Projektligji për Fondin Sovran është antikushtetues dhe, sipas saj, nëse bëhet ligj siç është ai do të dërgohet në Kushtetuese.

Ish-ministrja thotë se mendësia qeverisëse e Vetëvendosjes po i bën dëm vendit. "Pasi kanë kaluar disa muaj nga prerja e shiritit të projektit të vetëm infrastrukturor 'Ura e Saradranit, tanë qeveria po flet për Fondin Sovran. Sot e lexova Projektligjin për Fondin Sovran që është në konsultim publik. Kam shumë vërejtje, shumë pyetje, shumë komente, mbi të gjitha më vjen sinjerisht keq për mendësinë qeverisëse të LV-së dhe dëmet që po ia bën vendit. Tentativa me kapë çdo gjë, me shpërfillë çdo procedurë, çdo ligj, për më tepër me ligj për ta tejkular edhe Kushtetutën, këtë

vëtëm qeveria e LV-së e bën", ka shkruar Bajrami në "Facebook". Sipas deputetës opositare, Fondi ka për ta "zhvilluar vendin" duke anashkaluar krejt ligjet në fuqi. "Për këtë Fond, bordin dhe organet e tij, që do të emërohen nga Qeveria/LV-ja, s'ka për të pasur ligj të prokurimit - tenderët direkte me dosta/negocim i drejtpërdrejtë, s'ka nevojë për kontabilitet, raportim financiar, ligj të punës hiç se hiç, thjesht duhet me qenë i pëlqyeshëm për pushtetin dhe mjafton", është shprehur ajo.

Bajrami thotë se gjëra të tillë nuk do të lejohen. "Nëse ky projektligj bëhet ligj kështu siç është do të përfundojë në Gjykatën Kushtetuese si shumë të tjerë, sepse 'prima facia' ky ligj është antikushtetues", ka përfunduar deputetja e LDK-së.

# 6 betejat më vdekjeprurëse të Luftës së Parë Botërore



## Beteja e Parë e Marnës (6 – 9 shtator 1914)

Numri i viktimave: 150000

Një nga betejat e para me shumë viktima të zhvilluara në Luftën e Parë Botërore u zhvilluar në Francën verilindore, rreth luginës së lumit Marne, disa javë pasi gjermanët kishin pushtuar Belgikën. Tashmë në tokë franceze, gjermanët përparuan pa u sfiduar dhe arritin 30 milje larg Parisis.

Por francezët e përfanë me sukses vijën e trupave gjermane për të krijuar një boshllëk që u mbush me shpejtësi nga përforcime. Gjermanët u detyruan të tërhiqen mbi 50 milje në veri, ku gjermanët pothuajse deri në pikën në të cilën kishin filluar fushatën e tyre katastrofike.

## Beteja e Verdunit (21 shkurt – 18 dhjetor 1916)

Numri i viktimave: 330,000

Verduni konsiderohet si beteja më e gjatë në historinë moderne. Ishte e përgjakshme, rraskapitëse dhe

në fund ... e pakuptimit. Pasi gjermanët vendosën se mënyra më e mirë për të mposhtur britanikët ishte të mposhtmin aleatët e tyre, ata sulmuan qytetin e kalasë së Verdunit, që ishte bosh. Qyteti ishte i vendosur strategjikisht në verilindje të Francës në lumin Meuse dhe gjermanët filluan të merrnin kontrollin e nëntëmbëdhjetë kalave kryesore të tij.

Deri në qershori, dukej sikur ata do të kishin sukses, por shirat e verës ngadalësuan përparimin. Një kundërofensivë e strukturuar nga aleatët, e cila përfshinte njësi luftarakë me turne për të kufizuar lodhjen e betejës, i detyroi gjermanët të tërhiqeshin pothuajse deri në pikën në të cilën kishin filluar fushatën e tyre katastrofike.

## Beteja e Somme (1 korrik – 18 nëntor 1916)

Numri i viktimave: 300,000

Ndoshta beteja më famëkeqe në historinë moderne ushtarakë ndodhi në Francën Veriore në mes të luftës. Plani ishte që qytetit Kanadezët

dhe francezët të përfitonin nga Beteja e vazhdueshme e Verdunit, ku ishte përqendruar një pjesë e konsiderueshme e ushtrisë gjermane. Megjithatë, mbrojtja gjermane ishte nënverësuar shumë.

Vetëm ditën e parë u vranë një numër rekord prej 19,240 trupash britanike. Ajo që pasoi ishte një luftë e ashpër, ndërsa të dyja palët gjermane në llogore: në 141 ditët që zgjati, aleatët fituan jo më shumë se shtatë milje tokë. Në kohën kur Beteja e Sommes kishte përfunduar, mbi një milion personel nga të dyja palët ishin ose të vdekur, ose të plagosur.

## Beteja e Arrasit (9 prill – 16 maj 1917)

Numri i viktimave: 285,000

Ideja e fushatës ishte që francezët të goditnin fort gjermanët në rajonin Aisne, ndërsa britanikët do të sulmonin mbrojtjen gjermane rreth qytetit të bukur të Arras në Francën Veriore. Në të njëjtën kohë, kanadezët përqendruan divizionet e tyre në sigurimin e Ridge Vimy, rreth pesë milje në veri të qendrës së qytetit. Kanadezët

morën me sukses kreshtën dhe britanikët bënë një fillim të mirë në linjat gjermane pasi i goditën fort me mbi 2.5 milionë predha. Por në vend që të përfitonin nga avantazhet e hershme, gjermanët shpejt i kthyen në një ngërç të përgjakshëm dhe francezët pësuan aq shumë viktima, saqë mungesa e moralit çoi në shpërbërjen e ushtrisë. Fushata dështoi.

## Beteja e Passchendaele (31 korrik – 6 nëntor 1917)

Numri i viktimave: 585,000

Beteja e Tretë e Ypres, siç njihet, ishte ndoshta beteja më vdekjeprurëse e Luftës së Parë Botërore. Sir Gjenerali Douglas Haig ishte njeriu përgjegjës për urdhërimin e granatimeve fillestare masive të linjave gjermane në një përpjekje për të dëbuar gjermanët njëherë e përgjithmonë. Por gjermanët nuk ishin aq të dobët sa supozohet, dhe rezultati ishte një gjakderdhje e paprecedentë. 1917 pa një vëllim të jashtëzakonshëm reshjesh nëzonë duke krijuar moçal dhe duke

mbytur njerëz, kuaj dhe pajisje në të. Pasi pretenduan fitoren në nëntor, aleatët kishin fituar jo më shumë se pesë milje. Një vit më vonë, fushëbeteja u braktis.

## Ofensiva e Pranverës (21 mars – 17 korrik 1918)

Numri i viktimave: 328,000

Gjithmonë ka diçka prekëse kur shikon shifra të pakuptueshme viktimavsh, pak para se të shpërthej paqja. Kjo ndjenjë është tipike në një nga betejat e fundit të Luftës së Parë Botërore, Ofensiva e Pranverës. Pasi Gjermania mundi Rusinë në lindje, gjeneralët vendosën të dërgonin trupat e mbeturë gjermane, 48 divizione, për të larguar aleatët në frontin perëndimor.

Pasi i bombarduan me predha, trupat gjermane goditën vijën e armikut, madje duke rimarrë Sommen. Por pa furnizime jetike, morali i trupave u shemb. Ndërsa shifrat e viktimave u rritën, francezët nisën një kundërsulm të egër që do të shënonë fillimin e fundit të luftës që mori jetën e rreth 20 milionë njerëzve.

# Robert Waldinger: Lumturia varet nga ajo që na mungon



Nga Aser García RADA

Psikiatri Robert Waldinger praktikon atë që predikon. Si drejtor i Studimit për Zhvillimin e të Rriturve në Universitetin e Harvardit, një nga studimet më të gjata se si të jetosh një jetë të shëndetshme, të lumtur dhe plot qëllime, ai di se si të zbatojë "ilaçin e tij", dhe atë e tregon me dashamirësi.

Aktualisht ai po promovon librin e tij të ri "Jeta e mirë: Leksione nga studimi më i gjatë mbi lumturinë e botës", një libër i bashkëshkuar me Marc Schulz, drejtor i asocuar i këtij studimi, që zbulon gjetjet kryesore të Studimit të Harvardit për Zhvillimin e të Rriturve, i cili po vazhdon prej 85 vitesh, dhe ka arritur të bëjë zbulime, të cilat kanë habitur edhe vetë studiuesit.

Paraardhësit e Waldinger e nisën studimin në vitin 1939 me 2 investigime të pavarura. Njëri shqyrtoi 268 studentë të Harvardit – mes tyre John F. Kennedy – dhe tjetri 456 adoleshentë nga lagjet e marginalizuara të Bostonit. Të gjithë pjesëmarrësit ishin meshkuj dhe të bardhë. Gjatë rrjedhës së studimit, studiuesit

panë që ata burra të rriten dhe të vdesin, dhe me kalimin e kohës përfshinë në studim fëmijët dhe partnerët e tyre. Waldinger është tashmë drejtori i katërt i këtij studimi. Ai jeton në Boston me gruan e tij, me të cilën është martuar prej 37 vitesh. Dikur donte të bëhej aktor, por e kishte të vështirë të përballej me kritikat negative.

## Profesor, çfarë është lumturia për ju?

Për mua është përfshirja në aktivitete kuptimplota, dhe të qenit i lidhur me njerëzit që më interesojnë dhe që kujdesen përmua.

## A ndryshojnë perceptimet e lumturisë midis njerëzve të ndryshëm?

Ajo që ne e quajmë lumturi varet nga ajo që kemi nevojë. Pra, nëse keni pasur një jetë shumë të trazuar, ndoshta për ju lumturia është stabiliteti. Nëse keni pasur deri dje një jetë shumë të mërzitshme, ndoshta për ju lumturi janë ngjarjet që ju ngrenë adrenalini. Pra, lumturia varet pjesërisht nga ajo që mendojmë se na mungon.

Por studimi sugjeron se lumturia ndahet në 2 kategori. E para është ajo hedoniste: A po ia kaloj mirë tan? A po e shijoj këtë filxhan kafe që po pi tan? Tjetra është mirëqenia eudemonike siç e përcaktonte Aristoteli. Ajo ka të bëjë me ndjenjën se jeta është kuptimplotë, se ajo ia vlen.

## A ka ndonjë dallim në mënyrën se si burrat dhe gratë e ndjejnë lumturinë, apo njerëzit e moshave të ndryshme?

Nuk mendoj se femrat dhe meshkujt janë të ndryshëm. Po ashtu, nuk mendoj se ka dallime midis grupmoshave. Ajo që dimë, është se të gjithë duan diçka nga të dyja llojet e lumturisë. Të gjithë e duan një kënaqësi momentale, dhe askush nuk dëshiron të ndiejë se jeta e tij nuk ka kuptim. Por ne e bëjmë një lloj lumturie prioritet në varësi të mënyrës se si jemi, dhe ndoshta në varësi të fazave të jetës sonë. Ne mendojmë se shumë adoleshentë duan më shumë mirëqenie hedonistike. Por nuk jam i sigurt për këtë. Ajo që di është se të dy llojet e mirëqenies janë të rëndësishme për shumicën e njerëzve, por në shkallë të ndryshme.

Ju e vini theksin tek rëndësia e marrëdhënieve sociale. Po si mund të arrihet kjo në një epokë të karakterizuar nga vëtmia dhe marrëdhëni jo tradicionale?

Nuk keni nevojë të jeni në çift apo në një lidhje romantike për të marrë përfitimet nga raportet sociale. Faktori kryesor është ngrrojtësia e lidhjes, nga ndjenja e përkatësisë dhe ajo e ndërveprimi social pozitiv. Dhe ne marrim një pjesë të këtij përfitimi nga takimet miqësore me kamarierin apo banakierin kur e pini kafen çdo ditë apo nga postieri që ju sjell postën. Dhe sigurisht, nga miqtë, të afërmitt. Unë mendoj se në SHBA, rreth 30 për qind e njerëzve jetojnë vetëm. Por shumë nga ata njerëz janë shumë të lumtur. Ata nuk kanë një partner romantik, por kanë marrëdhënie që u ofrojnë atë për të cilën kanë nevojë.

Ju gjithashtu theksoni se bujaria, kurioziteti dhe fleksibiliteti për t'u përshtatur me ndryshimet janë të lidhura me lumturinë, gjëra që disa njerëz mund t'i konsiderojnë naivë...

Shumë studime serioze kanë treguar se bujaria i bën njerëzit më të lumtur. Po ashtu të gjitha urtësítë dhe traditat fetare – unë praktikoj filozofinë Zen dhe Budizmin – flasin vazhdimisht

për mirësinë dhe bujarinë. Për shekuj me radhë, njerëzit e kanë kuptuar se në fakt funksionon kështu. Ndërkohë njerëzit që janë më të përqendruar tek vetja, janë më pak të lumtur.

## Po në lidhje me spiritualitetin apo besimet fetare?

Në studime të këtij lloji, kur kahasojmë njerëzit me apo pa besime fetare dhe shpirtërore, njëri grup nuk është më i lumtur se sa tjetri. Njerëzit që e thanë këtë, iu duk ngushëlluese në kohë të vështira, por mesatarisht nuk ishin më të lumtur se të tjerët.

## Si ka ndikuar në jetën tuaj udhëheqja e këtij studimi?

Më ka frymëzuar t'i kushtoj më shumë vëmendje marrëdhënieve të mia. Unë jam profesor, mund të punoja gjatë gjithë kohës, duke lexuar, shkuar. Fillova t'i kushtoj më shumë vëmendje qëndrimit në kontakt me miqtë, madje edhe gjatë pandemisë. Pra jam përpjekur të të praktikoj atë që u predikoj të tjerëve.

**Marrë me shkurttime nga "El País" – Bota.al**



## Finalja e Kupës në futboll luhet më 5 qershor

**GJILAN, 9 MAJ** - Finalja e Kupës së Kosovës në këtë sezoni do të luhet ndërmjet SC Gjilanit dhe FC Prishtinës. SC Gjilani u kualifikua në finale pasi e eliminoi Llapin në gjysmëfinale, kurse

Prishtina pati punë më të lehtë duke e mposhtur me lehtësi Vushtrrinë nga Liga e Parë. Gazeta Enigma raporton se finalja e Kupës së Kosovës mes SC Gjilanit dhe FC Prishtinës është vendosur që të luhet më 5

qershor në stadiumin "Fadil Vokrri" në Prishtinë. Kutojmë që përballja e fundit mes këtyre dy ekipeve ishte të dielën në stadiumin "Fadil Vokrri" në Prishtinë e cila përfundoi me rezultatin 0-0 dhe u luajt

në kuadër të xhiros së 33-të në Superligë. Vlen të theksohet se SC Gjilani pozicionohet në vendin e tretë me 51 pikë, vend që e dërgon në garat evropiane e ndjekur nga Prishtina në vendin e katërt me 44 pikë.



## Nora Gjakova përfundon e pesta në Kampionatin Botëror, sot garon Laura Fazliu

Prishtinë, 9 maj - Kampionia olimpike, Nora Gjakova, u rendit e shtata në Kampionatin Botëror, që po mbahet në Doha. Gjakova shënoi dy fitore, një tjetër e kaloi pa luftë, duke arritur sukseshtëm deri në çerekfinale, ku pësoi humbje. Rrugëtimin drejt medaljes së bronztë e vazhdoi përmes repesazhit, me ç'rast u ndal nga jugkoreanja, Mimi Huh. Me vendin e shtatë, Nora arkëtoi 520 pikë olimpike "Paris 2024", të cilat e mbajnë në pjesën e epërme të renditjes olimpike dhe botërore. Ndërsa Akil Gjakova shënoi dy fitore në Kampionatin Botëror të xhudos, për t'u ndalur në

raundin e tretë të kategorisë - 73 kg. Kampioni ynë i Evropës 2021, për shumë muaj kishte mbetur jashtë garave shkaku i lëndimit, nga i cili u kthyesh javë më parë. Kjo paraqitje vlerësohet e suksesshme, pasi mori edhe 320 pikë olimpike që e mbajnë në garë përkualifikim në Lojërat Olimpike "Paris 2024". Të martën ka garuar edhe Flaka Loxha, e cila shënoi një fitore, për t'u ndalur në të dytën. Ajo mori 240 pikë olimpike, kategoria -57 kg. Të hënën siq dihet ka garuar Kampionia olimpike, Distria Krasniqi, u rendit e pesta e botës në Kampionatin Botëror. Sot (e mëkurë) garon Laura Fazliu (-63 kg).



## Reali dhe City bëjnë paqe në përballjen e parë



**MADRID, 9 MAJ** - Real Madrid dhe Manchester City barazuan 1-1 në ndeshjen e parë gjysmëfinale të UEFA Champions League të luajtur në "Bernabeu", duke lënë të hapura llogaritë për aktin e kthimit me 17 maj. Pjesa e parë u dominua nga "Qytetarët". Në minutat e para, të besuarit e Guardiolës ishin kërkues, madje pretenduan për një penalti pasi Dias dhe Haaland u rrëzuan në zonë, por përkryesorin loja duhej të vazhdonte. Mbrotja angleze u gjet e papërgatitur në minutën e 36-të. Camavinga shfrytëzoj shpejtësinë e tij për të dalë

shpejt përpara, ai dha një pasim për Vinicius, me brazilianin që me një supergoditje nga distanca "shkundi merimangat". Në fillimin e pjesës së dytë, vendasit u afroan shumë me golin e barazimit. Kevin De Bruyne gaboi para portierit bashkëkombas Courtois, duke shpërdoruar një rast që të vjen një herë në jetë. De Bruyne shleu gabimin në të 67-tën, pasi vendosi ekuilibrat me një gjaujte të bukur. Pavarësisht rasteve në fund, të dyja skuadrat u kënaqën me këtë rezultat dhe do kërkojnë biletën e finales në "Etihad".

## Trepça e Prishtina sonte zhvillojnë edhe një përballje

**Mitrovica, 9 maj** - Trepça e Prishtina takohen në tjetër gjysmëfinale të rendësishme. Pasi u përballën në gjysmëfinale të Kupës së Kosovës, dy skuadrat me traditë takohen edhe në gjysmëfinale të garave të plejofit në Superligën e Kosovës në hendball. Nëndeshja e parë luhet të mëkurën prej orës 19:00 në palestrën

"Minatori" në Mitrovicë. Trepça e Prishtina kanë luajtur ndeshje të forta dhe interesante gjatë gjithë edicionit. Kështu ishte edhe të shtunën në Prishtinë dhe njëjtë pritet të jetë edhe të mëkurën mbrëma në Mitrovicë. Trepça e ka përfunduar kampionatin e rregullt në pozitën e dytë dhe do ta ketë përparrësinë e

terrenit në ndeshjen e tretë eventuale. Prishtina në kampionatin e rregullt përfundoi e treta. Skuadra mitrovicase të dielën e fitoi Kupën e Kosovës, për herë të parë pas 21 vjetësh. "Xehetarët" do të mundohen të përfitojnë nga momenti pozitiv, por Prishtina udhëton me plane tjera për në Mitrovicë.





REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**OIK**  
**Oda e infermierëve, mameve dhe profesionisteve të zdravstvenitës së Kosovës**  
**Komora medicinskej sestra, babica i ostalih zdravstvenih stručnjaka Kosova**  
**The Kosovo Chamber of nurses, midwives and other health professional**

Në bazë të nenit 8 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, Udhëzimit Administrativ Nr.07/2017 për Rregullimin e Procedurave për Themelimin e Marredhënieve së Punës në Sektorin Publik. Në bazë të nenit 20 pika 1.6 të Ligjit për Odat e Profesionistëve Shëndetësor Nr.04/L-150, nenit 23 pika 1.6 të Statutit të OIK-ut, vendimit të Këshillit Drejtues me Nr.Prot.506 të datës 07.04.2023 dhe mbështetur në Rregulloren Organizimi i Shërbimit Profesional Administrativ të OIK-ut, OIK shpallë këtë:

### KONKURS

Për keto pozita të punës:

#### I. Titulli i vendit të punës: Zyra për Projekte dhe Bashkëpunim Ndërkombtarë

Norma e punës: Orar i plotë (40 orë pune në javë)  
 Kontrata: Sipas legjislatacionit në fuqi  
 Raporton: Kryetarit të OIK-ut  
 Nr. i zyrtarëve: Një (1) Pozitë.

#### Përshtaki i detyrave të punës:

- Kordinon menagjimin, zbatimin dhe vlerësimin e projekteve;
- Ofron asistencë teknike për planin e aktiviteteve të projektit;
- Përgjegjës për të menagliuar të gjitha aspektet e ciklit të projektit duke përfshirë planifikimin, zbatimin, monitorimin, dhe vlerësimin;
- Merr pjesë në mënyrë aktive në të gjitha aktivitetet e projekteve;
- Prezenton projektin tek palët e interesit dhe bashkëpunon ngushtë me institucionet ku shtrihet projekt;
- Identifikon përfisutesit potencial në bashkëpunime me partnerët;
- Merr pjesë në hartimin e kontravave dhe marrëveshjeve të dalura nga nevojat e projekteve dhe nga aktivitetet me marrëdhënien ndërkombtare;
- Organizon trajnime dhe aktivitetet tjera të parapara me projekte për përfisutesit e projektit;
- Përgatit raporte për secilin aktivitet/projekt, sipas kërkesës së mbikqyrësit të drejtëpërdrejtë;
- Sigurohet që raportet narrative të projektit të përgatiten dhe dorëzohen në kohë duke marrë parasysh kërkesat e raportimit nga donatorët;
- Përcjellë dhe përgatit të gjitha termat e referencës për ekspertët lokal dhe ndërkombtarë;
- Mbikqyrë angazhimin e ekspertëve lokal dhe ndërkombtarë krahas termave të referencës;
- Ndjejkë/Monitoron progresin e përditshëm të aktivitetave të projektit, në krahasim me aktivitetet e planifikuar të punës si dhe objektivave të përgjithshme të projektit;
- Sigurohet që kontratat me donatorët t'ju menaxhohen në përpunë me termat e tyre të referencës;
- Bënë monitorimin e shpenzimeve të aktivitetave dhe zbatimin e buxhetit në përpikmëri;
- Sigurohet që buxheti të respektohet në mënyrë strikte;
- Përgatit, përditëson, publikon, dhe shpërndan dokumentacionin e projektit;
- Mbështet ekipet e projekteve, në të gjithë prototofolin e punës nga fillimi i projektit deri në mbylljen për të gjitha çështjet që lidhen me zbatimin e projektit;
- Bashkëpunon në programin e EVP-së të profilizuar në harmoni me standartet Europiane;
- I përgjigjet Kryetarit të OIK;

#### Shkollimi i kërkuar:

- Diploma e Fakultetit
- 2 (dy) vite përvrojë pune.

#### Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim:

- Diploma e Fakultetit Universitar
- Dokumenti i identifikimit (Letërnjoftimi) kopje.
- Dëshmi për përvoven e punës.

#### II. Titulli i vendit të punës: Zyrtarë administrativ për anëtarësim, licencim dhe rilicencim:

Norma e punës: Orar i plotë (40 orë pune në javë)  
 Kontrata: Sipas legjislatacionit në fuqi  
 Raporton: Kryetarit të OIK-ut  
 Nr. i zyrtarëve: Një (1) Pozitë.

#### Përshtaki i detyrave të punës:

- Pranimi i kërkësave për anëtarësim, regjistrim, licencim dhe rilicencim;
- Organizimi i takimeve të Komisioneve të lëmive të ndryshme për shqyrtim të aplikacioneve të ndryshme;
- Mbajtja e Procesverbaleve;
- Përgaditja dhe procedimi i licencave dhe akteve tjera pas aprovimit të komisionit;
- Regjistrimi i fletëpagesave (të hyrave) të takave për shërbimet e kryera;
- Barazimet me raportet e bankave;
- Lëshimi i akteve dhe dokumenteve tjera sipas kërkesës së anëtarëve të odës të cilët janë nën përgjegjësit e Zyrës;

#### Shkollimi i kërkuar:

- Diploma e Fakultetit
- 1 (një) vit përvrojë pune.

#### Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim:

- Diploma e Fakultetit Universitar
- Dokumenti i identifikimit (Letërnjoftimi) kopje.
- Dëshmi për përvoven e punës.

#### III. Titulli i vendit të punës: Zyrtarë administrativ për anëtarësim, licencim dhe rilicencim:

Norma e punës: Orar i plotë (40 orë pune në javë)  
 Kontrata: Me periudhë të caktuar, (zëvendësim pushim i lehonisë)  
 Raporton: Kryetarit të OIK-ut  
 Nr. i zyrtarëve: Një (1) Pozitë.

#### Përshtaki i detyrave të punës:

- Pranimi i kërkësave për anëtarësim, regjistrim, licencim dhe rilicencim;
- Organizimi i takimeve të Komisioneve të lëmive të ndryshme për shqyrtim të aplikacioneve të ndryshme;
- Mbajtja e Procesverbaleve;
- Përgaditja dhe procedimi i licencave dhe akteve tjera pas aprovimit të komisionit;
- Regjistrimi i fletëpagesave (të hyrave) të takave për shërbimet e kryera;
- Barazimet me raportet e bankave;
- Lëshimi i akteve dhe dokumenteve tjera sipas kërkesës së anëtarëve të odës të cilët janë nën përgjegjësit e Zyrës;

#### Shkollimi i kërkuar:

- Diploma e Fakultetit
- 1 (një) vit përvrojë pune.

#### Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim:

- Diploma e Fakultetit Universitar
- Dokumenti i identifikimit (Letërnjoftimi) kopje.
- Dëshmi për përvoven e punës.

#### Aftësitë / përvoja dhe atributet e tjera që kerkohen:

- Të ketë shkakthësi të dëshmuara dhe efektive të komunikimit me shkrim dhe me gojë;
- Të ketë njohuri të gjuhëve zyrtare në përdorim;
- Njohja e punës me kompjuter është e domosdoshme.

#### Kushtet e pjesëmarrjes në konkurs:

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, si dhe të ketë aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave.

**Procedurat e konkurrimit:** Konkurimi është i hapur për të gjithë kandidatët e interesuar.

**Data e mbylljes së konkursit:** *15 ditë nga data e publikimit në mjetet e informimit.*

**Paraqitura e kërkësave:** Aplikacionet merren, plotësohet, dhe dorëzohen çdo ditë pune nga ora 09:00-14:00 në zyreën e OIK-ut.

**Adresa:** Rruga "Holger Pedersen" mbraja QKUK-së kompleksi banesor Vëllazërit Asllani.

Të gjitha dokumentet dhe dëshmitë profesionale t'i bashkëngjiten aplikacionit.

Aplikacionet e dërguara pas datës së mbylljes së konkursit dhe kërkësat e pa kompletuara nuk do të pranohen.

Kandidatët të cilët aplikojnë, të ofrojnë dëshmitë sipas konkursit të shpalur, për ndryshe kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e konkursit nuk do të thirren për intervistim.

Prishtina,  
Datë: 08/05/2023



# Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punës
- Shërbime shkrimi

#### Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook

[www.facebook.com/gjeipuneshpeite](http://www.facebook.com/gjeipuneshpeite)

# RESTAURANT

# SWISS

## TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVO  
QEVERTA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA

INSTITUT I HISTORISÉ "ALI HADRI" - PRISHTINÉ  
INSTITUTE OF HISTORY "ALI HADRI" - PRISHTINA  
INSTITUT ZA ISTORIJU "ALI HADRI" - PRIŠTINA  
GOVERNMENT OF KOSOVA

Nr. Org.	1-H	Nr. prot.	04/195/23
Org. Dati		Dati:	08.05.23
Urgj. Dati		Br. prot.	
No. Façade	04	Date:	
No. Papier		Datum:	
Br. Stranica			



Prishtinë, 10.05.2023

Në bazë të neneve 25, 26 dhe 27 të Ligjit nr. 04/L-135 për Veprimtari Kërkimore-Shkencore (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 11/02 maj 2013), neneve 22, 23, 24 dhe 25 të Statutit të Institutit të Historisë "Ali Hadri" në Prishtinë, nenit 4 paragrafi 1, 2, 3, 4 dhe 5, nenit 5, paragrafi 1.1, 1.3, 1.4, 1.5, 1.6, 1.7 dhe 1.9, si dhe nenit 7 të Udhëzimit Administrativ (MPMS) nr. 07/2017 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik, të cilët aplikohen përshtatshëmrisht për konkursin në mungesë të bazës specifike ligjore në Ligjin nr. 04/L-135 për Veprimtari Kërkimore-Shkencore dhe Statutin e Institutit të Historisë "Ali Hadri" në Prishtinë, Këshillit Drejtues në mbledhjen e mbajtur më datë 08.05.2023 mori vendimin për të shpall:

#### KONKURS

Titulli i pozitës: Drejtor

Institucioni: Institut i Historisë "Ali Hadri" – Prishtinë

I përgjigjet: Këshillit Drejtues të Institutit të Historisë "Ali Hadri"

Vendi: Prishtinë

Kandidatët duhet t'i plotësojnë kushtet si në vijim:

- Të jetë doktor i shkencave të historisë, përkatësisht t'i plotësojë kushtet për t'u zgjedhur së paku në titullin bashkëpunëtor i lartë shkencor.
- Të ketë përvojë dhe aftësi të dëshmuara në organizimin dhe udhëheqjen e punëve kërkimore-shkencore.
- Kandidati, me rastin e konkurrimit duhet t'i paraqesë projektin për zhvillimin e punës kërkimore-shkencore, si dhe t'i organizimit të punëve të tjera në Institut.

**Detyrat dhe përgjegjësia:** Drejtori i Institutit të Historisë "Ali Hadri" – Prishtinë, ka detyrimet dhe përgjegjësitë e ngarkuara me ligj, me Statut të Institutit të Historisë "Ali Hadri" – Prishtinë:

- Udhëheq dhe e përfaqëson Institutin dhe është përgjegjës për ligjshmërinë e veprimtarisë së Institutit;
- Organizon veprimtarinë e Institutit dhe ndërmerr masa për realizimin e saj;
- Kryeson Këshillit Drejtues, si dhe përkujdeset për zbatimin e vendimeve të tyre;
- Kryeson Këshillit Shkencor;
- Është urdhëruar dhe përgjegjës për zbatimin e planit financiar të Institutit;
- Organizon punën dhe veprimtarinë e Institutit;
- Nxjerr aktin për sistematizimin e vendeve të punës sipas propozimit të Këshillit Shkencor;
- Nënshkruan kontratat e punës me punëtorët e Institutit;
- Kryen edhe punë të tjera të përcaktuara me ligj dhe me statutin e Institutit.

**Kohëzgjatja e zgjedhjes:** Mandati i drejtorit është katër vjet.

Kandidatët duhet t'i paraqesin këto dokumente:

- Kërkeshë
- Biografinë (CV)
- Certifikatën e lindjes jo më të vjetër se gjashtë muaj;
- Përbledhjen e përvojës menaxheriale, dhe përvojës kërkimore-shkencore;
- Vërtetim të lëshuar nga organi kompetent që vërteton se ndaj kandidatit nuk është duke u zhvilluar hetimi;

#### INFORMATË E PËRGJITHSHME PËR KANDIDATET

Zgjedhja e drejtorit të Institutit të Historisë "Ali Hadri" bëhet në pajtim me dispozitat e Ligjit nr. 04/L-135 për Veprimtari Kërkimore-Shkencore, Statutit të Institutit të Historisë "Ali Hadri" dhe Udhëzimin Administrativ (MPMS) nr. 07/2017, për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik.

Dokumentet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim nëse arrinë brenda 4 ditësh, kurse dokumentet që arrinë pas këtij afati dhe ato të pakompletuara nuk do të shqyrohen fare.


Kandidatët, dokumenteve të tyre duhet ti bashkëngjisin kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin, përvojën dhe dokumentacionet tjera të nevojshme që kërkon pozita për të cilën konkurojnë.

Dokumentet e kompletuara dorëzohen në Institutin e Historisë në Prishtinë (në objektin e Agjencisë Shtetërore të Arkivave të Kosovës) katër i dytë, zyra e Bibliotekës, adresë: Rr. „Arbnor e Astrit Dehari“ nr. 25 | 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës.

Konkursi mbeten i hapur 15 ditë nga data e publikimit.

Për informata shështë mund të kontaktoni në këtë nr. tel: 038/ 512-303, prej orës 08:00 - 16:00 (apo në ueb-faqen <https://ih-rks.org/>).

Nr. Org.	1-H	Nr. prot.	04/195/23
Org. Dati		Dati:	08.05.23
Urgj. Dati		Br. prot.	
No. Façade	04	Date:	
No. Papier		Datum:	
Br. Stranica			



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVO  
QEVERTA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA  
GOVERNMENT OF KOSOVA

INSTITUT I HISTORISÉ "ALI HADRI" - PRISHTINÉ  
INSTITUTE OF HISTORY "ALI HADRI" - PRISHTINA  
INSTITUT ZA ISTORIJU "ALI HADRI" - PRIŠTINA

Priştinë, 10.05.2023

Na osnovu članaka 25, 26 i 27, Zakona br. 04/L-135 o Naučno Istraživačkoj Delatnosti - (Službeni List Republike Kosova, br. 11/02 Maja 2013); člana 22, 23, 24 i 25 Statuta Instituta za Istoriju "Ali Hadri" u Prištini; član 4 stav 1, 2, 3, 4 i 5, član 1, stav 1.1, 1.3, 1.4, 1.5, 1.6, 1.7 i 1.9, kao i član 7 Administrativno Uputstvo (MRSZ) BR.07/2017 o regulisanje procedura konkursa na javnom sektoru, koji se na odgovarajući način primenjuju za konkursa u nedostatu posebnog pravnog osnova u Zakonu br. 04/L-135 za Naučno Istraživačkoj Delatnosti i Statut Instituta za Istoriju "Ali Hadri" u Prištini, Upravni savet na sednici održanoj 08.05.2023 doneo odluku da raspisuje:

#### KONKURS

Zvanje: Direktora

Institucija: Istoriski Institut "Ali Hadri" - Priština

Odgovara: Upravnom Savetu Istoriskog Instituta "Ali Hadri" – Priština

Mesto: Priština

Kandidati moraju da ispunjavaju sledeće uslove:

- Da je doktor istorijskih nauka, odnosno da ispunjava uslove za izbor u zvanje visoka naučnog saradnika.
- Da ima dokazano iskustvo i veštine u organizaciji i rukovođenju naučno-istraživačke delatnosti.
- Kandidati će, povodom konkursa, predstaviti projekat za razvoj naučno-istraživačke radova, kao i organizaciju drugih radova u Institutu.

**Dužnosti i odgovornosti:** Direktor Instituta za istoriju "Ali Hadri" - Priština, ima obaveze i odgovornosti određene zakonom, a Statutom Instituta za istoriju "Ali Hadri" - Priština:

1. Rukovodi i predstavlja Institut i odgovoran je o zakonitosti delovanja instituta;
2. Rukovodi i organizuje rad i delovanje instituta i preduzima mera za njegovu realizaciju;
3. Upravlja Upravnog odborom, i stara se o sprovođenju njihovih odluka;
4. Upravlja naučnim savetom;
5. Komanduje i odgovoran je za sprovođenje finansijskog plana Instituta;
6. Organizuje rad i delatnost Instituta;
7. Donosi akt za sistematizaciju radnih mesta prema predlogu naučnog saveta;
8. Potpisuje radne ugovoresaradnicima Instituta;
9. Vrši i druge radne utvrđene zakonom i Statutom instituta.

**Trajanje izbora:** Direktor se bira na period od četiri (4) godine.

**Kandidati moraju dostaviti sledeća dokumenta:**

- Zahtev
- Biografija (CV)
- Izvod iz registra rođenih ne stariji od šest meseci;
- Rezime menadžerskog iskustva i istraživačko-naučnog iskustva;
- Uverenje izdata od strane nadležnog organa kojim se dokazuje da se protiv kandidata ne vodi se istraga.

#### Opšti podaci za kandidate:

Direktor Instituta Istorije "Ali Hadri" bira se u skladu sa odredbama Zakona br. 04 / L - 135 za naučno istraživačkoj delatnosti - i Statuta Instituta Istorije "Ali Hadri" i Administrativno Uputstvo (MRSZ) br.07/2017 o regulisanje procedura konkursa na javnom sektoru.

Prijave poslate poštoma, na kojima se nalazi poštanski žig na dostavi izvršenoj poslednjeg dana roka za prijavu, smatraće se važećim i razmatraće se ukoliko stignu u roku od 4 dana, dok prijave koje stignu nakon ovog roka i one nepotpune neće biti upoštevane razmatrane

Kandidati su dužni da uz svoja dokumenta prilože kopije dokumentacije o stručnoj spremi, iskustvu i drugu neophodnu dokumentaciju koju zahteva radno mesto za koje konkurišu.

Popunjena dokumenta predaju se Institutu za istoriju u Prištini (u objektu Državne Arhivske Agencije Kosova), drugi sprat, kancelarija biblioteke, adresă: Ul. „Arbnor e Astrit Dehari“ br. 25 | 10000 Priština, Republika Kosova.

Konkurs ostaje otvoren 15 dana od dana objavljuvanja.

Za dodatne informacije možete se obratiti na ovaj broj. tel: 038/ 512 - 303, od 08:00 - 16:00 (ili na sajt <https://ih-rks.org/>).



Në mbështetje të nenit 8, nenit 10 nën par. 2.2 dhe nenit 15 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës i shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me datë 01.12.2010, lidhur me nenin 4 dhe nenin 5 të Udhëzimit Administrativ Nr. 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik i cili është pjesë e Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës i cili është i shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me datë 31.10.2017, nenit 8 par. 4, nenit 11, nenit 21 nën par. dhe 2.2 dhe nenit 25 të Rregullores Nr. 55/21 për Marrëdhënien e Punës të N.P.L "Përparimi" Sh. A. në Vushtrri e miratuar me datë 21.12.2021 nga Bordi i Drejtoreve të N.P.L "Përparimi" Sh. A, e duke u bazuar në vendimin me nr. 516/23 të datës 03.05.2023 të Kryeshefit Ekzekutiv, N.P.L "Përparimi" Sh. A me datë 05.05.2023 shpall:

### KONKURS PUBLIK

#### I. Titulli: Elektricist

Numri i ekzekutesve: 3

Orët e punës: 40 orë në javë

Kohëzgjatja e emrimit: Me kohë të caktuar një (1) vit, nga të cilat gjashtë (6) muaj do të jenë punë provuese, me mundësi vazhdimi.

Përgatitja profesionalë: Shkolla e mesme

Përvaja e punës: Preferohet një (1) vit

I raporton: Kryeshefit Ekzekutiv

Koefficienti i pagës: Sipas aktit të brendshëm të ndërmarrjes

#### Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësive të punës:

- Është përgjegjës për punët që kanë të bëjnë me mirëmbajtjen e ndriçimit publik.
- Zbaton detyrat dhe aktivitetet operative të përcaktuara nga udhëheqësi i tij.
- Është përgjegjës për mirëmbajtjen e ndriçimit, si dhe punët tjera të elektrikes në ndërmarrje.
- Mban përgjegjësi për materialin e shpenzuar, si dhe shpenzimet e materialit i shënon në dëshmitë përkatëse sipas dokumentacionit të NPL.
- Për punën e vet i përgjigjet Udhëheqësit të njësisë së Logistikës.

#### Kushtet e veçanta

- Trajnimë tjera gjatë karrierës profesionalë;
- Aftësi të mira komunikuese;
- Të ketë aftësi të mira kompjuterike.

#### Aplikacionit i duhet bashkangjitur:

- Formulari për aplikim i N.P.L "Përparimi" Sh. A - Vushtrri.;
- Dëshmitë për kualifikimin shkollor (Diploma të sillet e noterizuar);
- Ekstraktin e lindjes (Duhet të jetë original);
- Certifikatën nga Gjykata në lidhje me të kaluarën kriminale e cila nuk duhet të jetë më e vjetër se gjashtë (6) muaj.
- Dëshmitë për përvojën e punës nëse ka;
- Kopjen e letërnjoftimit;

#### Konkursi mbetet i hapur pesëmbëdhjetë (15) ditë nga dita e publikimit.

Kandidatët e interesuar, formularin për aplikim mund ta marrin dhe ta dorëzojnë në zyrën e Arkivës të N.P.L "Përparimi" Sh. A në qytetin e Vushtrrisë, rr. "Gjergj Kastriot Skënderbeu" nr. 82, (ish objekti i TMK-së afér Gjykatës Themelore Mitrovicë - dega në Vushtrri) çdo ditë pune nga ora 08:00 deri në ora 16:00.

Kandidatët të cilët konkurrojnë duhet të shënojnë saktë adresën, numrin e telefonit kontaktues si dhe e-mail adresën. Shpallja është e hapur nga data 05.05.2023 deri me datë 19.05.2023 në ora 16:00.

N.P.L "Përparimi" Sh. A në Vushtrri ofron mundësi të barabarta punësimi për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës. Për informata shtesë mund të kontaktoni në këtë nr. tel. 044 - 157 - 075.

Vërejtje: Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen, ndërsa aplikacionet e mangëta refuzohen.



U skladu sa članom 8, članom 10 stavom 2.2, članom 15 Zakona br. 03/L-212 o radu objavljenom u Službenom listu Republike Kosovo dana 01.12.2010, u vezi s članom 4 i članom 5 Administrativnog uputstva br. 07/2017 o uređivanju postupka konkursa u javnom sektoru, koji je dio Zakona br. 03/L-212 o radu, koji je objavljen u Službenom listu Republike Kosovo dana 31.10.2017, članom 8 stavom 4, članom 11, članom 21 stavom 2.2 i članom 25 Pravilnika br. 55/21 o radnom odnosu N.P.L "Përparimi" Sh. A. u Vushtrri, usvojenog dana 21.12.2021. od strane Upravnog odbora N.P.L "Përparimi" Sh. A., a u skladu s odlukom br. 516/23 od 03.05.2023. godine Komesara za izvršenje, N.P.L "Përparimi" Sh. A. 05.05.2023 objavljuje:

### JAVNI KONKURS

#### I. Naslov: Električar

Broj izvršitelja: 3

Radni sati: 40 sati sedmično

Trajanje imenovanja: Na određeno vreme od jedne (1) godine, od čega će šest (6) meseci biti probni rad, sa mogućnošću produženja.

Stručna spremă: Srednja škola

Radno iskustvo: Poželjno jedan (1) godine

Izvještava: Izvršni direktor

Koeficijent plaće: Prema internom aktu preduzeća

#### Opis zaduženja i odgovornosti posla:

- Opis poslova i odgovornosti:
- Odgovoran je za poslove održavanja javne rasvete.
- Izvršava zadatke i operativne aktivnosti koje su mu određene od strane svog rukovodioca.
- Odgovoran je za održavanje rasvete, kao i drugih elektrotehničkih poslova u preduzeću.
- Odgovoran je za potrošeni materijal i beleži troškove materijala u odgovarajuće dokumente prema NPL dokumentaciji.
- Odgovoran je svom rukovodiocu u jedinici za logistiku.

#### Posebni uslovi:

- Dodatna obuka tokom karijere;
- Dobre komunikacione veštine;
- Dobre računarske veštine.

#### Aplikaciji mora da priloži:

- Formular za prijavu N.P.L "Përparimi" Sh. A - Vučitru.;
- Dokaz o kvalifikaciji školovanja (diploma se dostavlja ovjerena);
- Izvod iz matične knjige rođenih (mora biti original);
- Uvjerenje suda o krivičnoj prošlosti koje ne smije biti starije od šest (6) mjeseci;
- Dokaz o radnom iskustvu, ako postoji;
- Kopiju lične karte.

#### Konkurs ostaje otvoren petnaest (15) dana od dana objavljinjanja.

Zainteresovani kandidati mogu uzeti i predati prijavni formular u kancelariji Arhiva N.P.L "Peprimi" Š. A u gradu Vučitru, ul. „Gjergj Kastriot Skenderbeu“ br. 82, (bivša zgrada TMK kod Osnovnog suda u Mitrovici – filiala u Vučitru) svakog radnog dana od 08:00 do 16:00 časova. Kandidati koji konkurišu moraju da unesu tačnu adresu, kontakt telefon i e-mail adresu. Oglas je otvoren od 05.05.2023 do 19.05.2023 u 16:00 časova.

N.P.L "Peprimi" Š. A u Vučitru nudi jednake mogućnosti zapošljavanja za sve gradane Republike Kosovo. Za dodatne informacije možete se obratiti na ovaj broj telefona. 044 - 157 - 075.

Napomena: Prijave dostavljene nakon navedenog roka neće biti prihvácene, a nepotpune prijave će biti odbijene.



The banner features the RC Cola logo at the top left, followed by a large yellow box containing the text "ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS". Below this, a blue box lists the "Quality & Sales Award Recipients" in alphabetical order.

**Quality & Sales Award Recipients**  
[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A Paraguay, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. Kosovo, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda Brazil, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC Tajikistan, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales

On the right side of the banner, there are images of a blue RC Cola can and a dark plastic bottle of RC Cola.



The advertisement features a circular tin of MEKA HALAL FOOD Pashtetë Pule. The tin is orange with a white lid. It shows a slice of pate with a layer of red sauce and some green herbs. Text on the tin includes "gluten free", "100 % mish pule", "cili e garantuar", and "pa konservues". The background is a stylized orange and white graphic.